



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Zhvillimit Rajonal
Ministarstvo za Regionalni Razvoj
Ministry of Regional Development

Prishtinë, datë, 04.06.2025

Në mbështetje të Nenit 53 (paragrafit 3) dhe nenit 80 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, bazuar në nenin 8 dhe 16 të Rregullores Nr. 04/2017 mbi Kriteret Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, Ligjin Nr. 08/L- 190 për Zhvillim Rajonal të Balancuar, Programi për Zhvillim Rajonal të Balancuar 2025 – Masa 4, Nën Masës 4.1/Mbështetja Financiare për OSHC-ve, Thirrjes Publike të MZHR-së së datës 18.03.2025 për mbështetje financiare të projekteve/ programeve të OJQ-ve në avancimin e zhvillimit socio ekonomik rajonal të balancuar, si dhe duke u bazuar në Vendimin nr. 290 të datës 11.04.2025 i ndryshuar dhe plotësuar me vendimin nr. 290/1 të datës 04.06.2025, të Sekretarit të Përgjithshëm të MZHR-së për Themelimin e Komisionit Vlerësues për vlerësimin e projekt-propozimeve të pranuar nga OJQ-të, Raportin nr. 388 të dt. 13.05.2025 të Komisionit Vlerësues të projekt/propozimeve të OJQ-ve, Komisioni vlerësues nxjerrë këtë:

V E N D I M

1. Në përputhje me detyrat dhe afatet e komisionit të përcaktuara në vendimin e lartpërmendur dhe duke u bazuar në Thirrjen Publike të datës 18.03.2025, Komisioni ka shqyrtuar dhe vlerësuar të gjithë dokumentacionin përkatës, të dorëzuar/dërguar nga OJQ-të në MZHR, ku sipas kriterëve Komisioni vlerësues ka shpallur rezultatet për objektivat si në vijim:

1.1 Objektivi - 1: Inkurajimi i të rinjëve dhe grave për hartimin e projekteve në fushën e Zhvillimit Socio-ekonomik Rajonal:

Equality, Bonevet – Kaçanik, Start UP (SuP), Sakuntala, People First, ESNAF, Frojdi, Instituti për Fuqizim dhe Pjesëmarrje të Rinisë – IFPR, Vizioni Rinor i Shalës, Qendra për Edukim, Inovacion dhe Zhvillim Profesional – AKADEMIJA, WELLE, Progresi dhe Avancimi Rinor në Kosovë – PARKS, Pontis / Ura, Sarski Behar, Center for Development Community – Millenium – CDCM, DKCG, Shoqata 'Fuqizimi i gruas dhe rinisë – FGRS', Nomad Kosova, Fol me zë, Our youth our future – RJAJ, Instituti për Integritet Publik, Shoqata 'Jeto Shëndetshëm', SDBC, Idetë e reja Ekonomike, Global Development Solutions – GLOBEDS, Rinia Aktive e Prizrenit.

1.2 Objektivi - 2: Promovimi dhe Zgjerimi i Zhvillimit Socio - ekonomik Rajonal:

Agjencia për Zhvillim Rajonal – AZHR Lindje, Agjencia për Zhvillim Rajonal – AZHR Perëndim, Agjencia për Zhvillim Rajonal – AZHR Jug, Agjencia për Zhvillim Rajonal – AZHR Veri, Agjencia për Zhvillim Rajonal – AZHR Qendër, Activism Roots, Rona, AGF 'Feminae', Kosovo Experts Group – KOEG, OMNES, Tourism and Marketing Institute – TMI, Instituti për Ekonominë e Tregut të Lirë – IETL, GLV Natyra, Youth Association for Human Rights, Retina, Politeia, D&D Business Support Center, Ardhmëria Jonë – AJ, Smart Inovation Centre, Polis, Instituti Kosovar për Qeverisje Lokale – KLGI, Instituti për Zhvillim dhe Integrim – IZHI, Kosova Turkiye Mezunlari Dernegi – TUMED, Leadership Development Association Albania LDA, Future Development Centre – FDC, Perspektiva Energjetike.

ARSYETIM

Komisioni brenda afatit të përcaktuar me Planin e veprimit ka bërë hapjen dhe vlerësimin e çdo aplikacioni. Në fazën e parë në bazë të kriterëve formale nga njëqind e nëntëdhjetë (190) aplikacione, për të kaluar në vlersimin e fazës së dytë vlerësimi përmbajtjes së aplikacioneve i kanë plotësuar kriteret njëqind e tre (103) aplikacione.

- Fazës së dytë të vlerësimit i janë nënshtruar njëqind e tre (103) aplikacione prej tyre projekte të OJQ-ve, sipas kriterëve të Thirrjes Publike, Komisioni ka vlerësuar se pesëdhjet e një (51) nga këto OJQ nuk i plotësojnë kriteret e fazës së dytë (vlerësimit përmbajtjesor) për të fituar financimin nga MZHR:
- Lipjan Youth Center – LYC, OPED, Makerspace Innovation Center – Prizren, Domine, KLJUC, VKBIK, Humanitaro Edukativno Rekreativni Centar – HERC, iCHAT, IDEA, Qendra Edukative & Aktivitete Inovative – EDUAKTIV, Dardana Press, Grupi Lokal i Veprimit ‘Kalaja’, Qendra e Aspiratave Rinore 18 Qershori, Eco Shqip, Bota e Rinisë – BR, ITI Pro Kosova, Women World Today and Now – WWTN, Qendra për Rini të Avancuar, Youth Education Center, Llogaritari, Iniciativa e Femrës Kosovare – IFK, Qendra Rinore Publike – Skenderaj, ZEBRA, Advocacy for Society Development – AFSD, Fruta e jetës, Shoqata – Rinia për Edukim dhe Angazhim për Llapjanët – REALL, Filizat e Bashkuar të Ardhmërisë Instituti per Kerkim dhe Zhvillim Social – IKZHS, Fondacioni Bonevet – Prishtinë, Organizata Rinore – AKTI, Anaom, Shoqëria Rinore – OAKTIV, Youth Partners, Nexus, Ekovizioni, QKZHQ, The Power of Mind, Era Fruit, Iniciativa për Zhvillim të Demokracisë, Qendra për Hapat Rinor, A.K.V. ‘Ilirida’ – Shtime, Qendra e Rinisë – Kaçanik, Trungu, ICAC, Shoqata për Mbrojtje të Ambientit – SPIRAL, FSHKTK, Planning Green, TOWN, IHAS – Sociometri, Values for Better Future, Një milion fuqi (shiko tabelën 2 të publikuar në Webfaqe të MZHR-së).

Gjatë vlersimit të fazës së dytë të njëqind e tre (103) aplikacione me Projekt Propozime të OJQ-ve, sipas kriterëve të Thirrjes Publike, Komisioni ka vlerësuar se pesëdhjet e dy (52) nga këto OJQ i plotësojnë kriteret e fazës së dytë (vlerësimit përmbajtjesor) për të fituar financimin nga MZHR:

- Agjencia për Zhvillim Rajonal – AZHR Lindje, Agjencia për Zhvillim Rajonal – AZHR Perëndim, Agjencia për Zhvillim Rajonal – AZHR Jug, Agjencia për Zhvillim Rajonal – AZHR Veri, Agjencia për Zhvillim Rajonal – AZHR Qendër, Activism Roots, Equality, Rona, Bonevet – Kaçanik, AGF ‘Feminae’, Start UP (SuP), Kosovo Experts Group – KOEG, Sakuntala, OMNES, People First, Tourism and Marketing Institute – TMI, ESNAF, Instituti për Ekonominë e Tregut të Lirë – IETL, GLV Natyra, Frojdi, Youth Association for Human Rights, Retina, Politeia, D&D Business Suport Center, Ardhmëria Jonë – AJ, Smart Inovation Centre Instituti për Fuqizim dhe Pjesëmarrje të Rinisë – IFPR, Polis, Vizioni Rinor i Shalës, Qendra për Edukim, Inovacion dhe Zhvillim Profesional – AKADEMIA, Instituti Kosovar për Qeverisje Lokale – KLGI, WELLE, Instituti për Zhvillim dhe Integrim – IZHI, Progresi dhe Avancimi Rinor në Kosovë – PARKS, Pontis / Ura, Sarski Behar, Center for Development Community – Millenium – CDCM, Kosova Turkiye Mezunlari Dernegi – TUMED, Leadership Development Association Albania LDA, Future Development Centre – FDC, DKCG, Shoqata ‘Fuqizimi i gruas dhe rinisë – FGSR’, Nomad Kosova, Perspektiva Energetike, Fol me zë Our youth our future – RJAJ, Instituti për Integritet Publik, Shoqata ‘Jeto Shëndetshëm’, SDBC, Idetë e reja Ekonomike, Global Development Solutions – GLOBEDS, Rinia Aktive e Prizrenit (shiko tabelen 1 të publikuar në Webfaqe të MZHR-së).

Në përputhje me detyrat dhe afatet e komisionit të përcaktuara me planin e punës të miratuar nga të gjithë anëtarët e komisionit, Komisioni ka shqyrtuar të gjithë dokumentacionin përkatës, duke vlerësuar secilin projekt - propozim veç e veç sipas Thirrjes Publike të datës 18.03.2025.

Komisioni ka pasur parasysh Rregulloren nr. 04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, rregullat e punës si aneks i kësaj rregulloreje dhe Thirrjen Publike nga MZHR të lartëcekur.

Afati i OJQ-ve për aplikim për dorëzimin e projekt-propozimeve ishte nga data 18.03.2025 deri më 11/04/2025.

Sipas Thirrjes Publike, kriteret e përcaktuara ishin të ndara në ato të përgjithshme dhe të veçanta, si më poshtë:

Kushtet formale të thirrjes:

Për të qenë e pranueshme për këtë thirrje organizata aplikuese duhet të:

- Të jetë e regjistruar në pajtim me Ligjin për Lirinë e Asocimit në Organizata Jo-Qeveritare;
- Të jetë e pajisur me numër fiskal të lëshuar nga Administrata Tatimore e Kosovë;
- Të ketë zotësi juridike, financiare dhe operacionale për zbatimin e projektit;
- Të ketë përvojë dhe aktivitete në fushën e zhvillimit socio-ekonomik dhe fushave të tjera të lidhura me këtë thirrje;
- Të ketë kryer të gjitha detyrimet tatimore dhe kontributet tjera të detyrueshme ose është në marrëveshje për shlyerjen e borxhit me ATK;
- Mos jetë në proces falimentimi në proces të shuarjes në procedura të mbledhjes së detyrueshme apo likuidimit;
- Mos të ketë pranuar mjete financiare për të njejtin aktivitet gjatë këtij viti. Aplikimi kërkon një deklaratë për shmangien e financimit të dyfishtë;
- Të dorëzojë një projekt propozim në përputhje me formularin e aplikimit të projektit dhe formularin e propozim buxhetit.

Kriteret specifike për aplikim:

Për të qenë i pranueshëm, aplikimi duhet të përmbushë këto kushte:

- Dorëzimi i projekt propozimit që përmban: qellimin, objektivat specifike, aktivitetet, kalendarin e realizimit, rezultatet e synuara, përfituesit e drejtperdrejte, dhe të dhënat tjera sipas formularit përkatës të përcaktuar në thirrje.
- Projekt propozimi të shoqërohet me një propozim buxhet sipas formatit të përcaktuar.
- Dorëzimi i të dhënave për personelin kyc, duke përfshirë listën e punonjësve dhe CV-të, së bashku me një deklaratë se ata pranojnë të punojnë për projektin me te cilin aplikohet.
- Dëshmia e zyrave dhe aseteve tjera logjistike të dedikuara për veprimtarinë e OJQ-së.
- Dëshmia për prani të një ueb faqeje ose llogarie në rrjetet sociale (si Facebook, Instagram, LinkedIn etj.) ku mund të shihen aktivitetet e OJQ-se.
- Në rast të bashkëfinancimit, aplikuesi duhet të sigurojë dëshmitë perkatese.
- Dëshmia e realizimit të projekteve të ngjashme nëse aplikohet për aktivitete të ngjashme (si objektivi I-rë ose II-te).
- Organizatat që aplikojnë për objektivin dy (2) "Promovimi dhe zgjerimi i zhvillimit socio-ekonomik rajonal" duhet të kenë qenë të regjistruara për të paktën tre (3) vite para dates së publikimit të thirrjes dhe të kenë përfunduar së paku tre (3) projekte të ngjajshme, ku dy prej tyre duhet të kenë kontribuar në zhvillimin socio-ekonomik rajonal të balancuar.
- Prezantimi i lejes/licencës për ushtrimin e veprimtarisë, në rastet ku kërkohet leje/licencë nga autoritetet publike.

Nga kjo, Komisioni duke marrë parasysh të lartëcekurat, ka konstatuar se gjithshej pesëdhjetë e dy (52) prej tyre i plotësojnë edhe kriteret e veçanta për t'u kualifikuar si përfituese të financimit nga MZHR.

Pjesë e vendimit është edhe raporti tabelar i Komisionit për OJQ-të përfituese të listës preliminare, i cili është shpallur në ueb faqen zyrtare të MZHR-së me datë 13.05.2025.

Komisioni i vlerësimit të projekt-propozimeve të OJQ-ve;

1. Ylber Çitaku Kryesues
2. Jeta Nushi, Anëtare
3. Amil Velija, Anëtar
4. Adnan Sogojeva, Anëtar
5. Kenan Gashi, Anëtar